



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1574 Prot.

Tiranë, më 22.12 2017

**VENDIM Nr. 248, datë 13.12.2017**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.13, datë 13.12.2017, pasi shqyrtoi *Konceptin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit* për varret e dëmtuara nga klandestinët në zonën e Himarës (Vacunero), paraqitur nga DRKK Vlorë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë *Konceptin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit* për varret e dëmtuara nga klandestinët në zonën e Himarës (Vacunero), paraqitur nga DRKK Vlorë.
2. Të kryhet Gërmimi arkeologjik i shpëtimit nga DRKK Vlorë në bashkëpunim me Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik. Raporti i tij të paraqitet në KKA e radhës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**MINISTRE**



**SEKRETAR I KKA**

**RUDINA ZOTO**